



Datë: 22.04.2025  
Numër Protokolli: 2679/2025

A.nr.435/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi –Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.435/2025, të datës 10.03.2025, të parashtruar nga ankuesi P.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.04.2025, mori këtë:

## V E N D I M

I **Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.435/2025, e datës 10.03.2025, e parashtruar nga ankuesi P.K.

II. **Anulohet** Konkursi me numër referencës RN00015903, për “Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 1, i shpallur me datë 29.11.2024 nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshme dhe Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi P.K (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 10.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.435/2025, lidhur konkursin Konkursi me numër referencës RN00015903, për “Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, me pretendimet ankimore se kriteret e

konkursit për pozitën ”Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, kanë qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe se Komisioni i Pranimit ka qenë në kundërshtim me Rregulloren nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse sipas dispozitave ligjore në fuqi, komisioni duhet të përbëhet prej pesë anëtarëve duke përfshirë tre nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse një nëpunës nga NjMBNJ dhe një nëpunës të kategorisë profesional të fushës përkatëse.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 20.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa kjo e fundit, më datë 08.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave administroi këto prova:*** Ankesën A.Nr.435/2025 të datës 10.03.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali i datës 07.06.2025, dërguar J.A, për P.K; Konkursi me numër referencë RN00015903, i datës 29.11.2024; Emali i datës 13.02.2025, dërguar P.K, për B.H; Njoftimi me numër protokolli 12/2025, i datës 11.02.2025, i nxjerr nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Lista e aplikantëve; Kopje e letërnjoftimit për P.K; Kërkesë për përgjigje në e datës 20.03.2025, dërguar përmes emailit nga R.K, për A.R; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 435/2025, e datës 08.04.2025; Vendimi me numër protokolli 2246, i datës 27.01.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit i nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit; Akt Emërimi me numër protokolli 86/2024, i datës 06.09.2024, për B.M; Akt Emërimi me numër protokolli 55/2024, i datës 05.09.2024, për N.S; Akt Emërimi me numër protokolli 52/2024, i datës 05.09.2024, për A.K; Vendimi me numër protokolli 2-2224, të datës 01.10.2024, për A.M, i nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit; Vendimi me numër protokolli 2-2175, të datës 05.11.2024, për H.L, i nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit; Aplikacionin i P.K, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 26.08.2009, për P.K; Diplomë e datës 30.10.2023, për P.K, e lëshuar nga Kolegji ”Univerzum”, Diplomë me numër protokolli 3347e datës 14.07.2024 , për P.K, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ” Hasan Prishtina”; Certifikatë e datës 20.11.2024, për P.K; Kontratë e punës e datës 14.09.2020, për P.K; Kontratë e punës e datës 03.05.2023, për P.K; Kontratë e punës e datës 09.03.2022, për P.K; Referencë e datës 04.03.2022; Kontratë e punës e datës 01.03.2021, për P.K; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, e datës 12.03.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 1597 e datës 02.05.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 2-354 e datës 26.02.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 2-1767 e datës 09.08.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 2-232 e datës 02.02.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 2-2342 e datës 19.06.2017; Vendimi me numër protokolli 2-2342, i datës 09.06.2017, i nxjerr nga u. d Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Pasqyra e Trustit për periudhën nga data 01.08.2022, deri me datën 20.12.2024, për P.K; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 2-3724 e datës 30.08.2019; Vërtetim me numër protokolli 3894, i datës 17.12.2024; Aplikacioni i L.D, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 257 e datës 18.09.2006, për I.B, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës”; Certifikatën e vitit 2023, për L.D; Certifikatën e datës 01.04.2021, për L.D; Certifikatën e datës 31.03.2021, për L.D; Certifikatën e datës 09.11.2014, për L.D; Certifikatën e datës 31.05.2021, për L.D; Vërtetim i datës 20.12.2024; Certifikatën e datës

31.03.2025, për L.D; Certifikatën e vitit 2020, për L.D; Vërtetim me numër protokolli 167/2015, e datës 12.05.2015, për L.D; Vërtetim me numër protokolli 177/2015, e datës 12.05.2015, për L.D; Vërtetim me numër protokolli 509/2015, i datës 02.06.2015; Pasqyra e Trustit për periudhën nga data 26.03.2008, deri me datën 18.12.2024, për L.D; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 05.02.2025, sipas kodit CN8276; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 05.02.2025, sipas kodit CN8121; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 05.02.2025, sipas kodit CN2654; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 05.02.2025, sipas kodit CN9798; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë, për L.D i datës 10.02.2025, nga anëtari i komisionit N.S; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë, për L.D i datës 10.02.2025, nga anëtari i komisionit N.S; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë, për L.D i datës 10.02.2025, nga anëtari i komisionit H.L; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë, për L.D i datës 10.02.2025, nga anëtari i komisionit A.K; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë, për L.D i datës 10.02.2025, nga anëtari i komisionit A.B; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë, për L.D i datës 10.02.2025, nga anëtari i komisionit B.N; Vendimi me numër protokolli 03/2025, i datës 13.01.2025, i nxjerr nga Divizionin i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Renditja përfundimtarë e kandidatëve e datës 10.02.2025; emali i datës 26.02.2025, dërguar nga N.R, për Sh.K; ; emali i datës 26.02.2025, dërguar nga A.R, për A,K, N.R; Emali i datës 26.03.2025, dërguar P.K, për SH.K; testi me shkrim i ankuesit;

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara në dispozitat ligjore, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 29.11.2024, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00015903, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ” Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 1 me afat aplikimi nga data 30.11.2024 deri me datë 29.12.2024.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 11.02.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati Liliana Drini, është vlerësuar me gjithsejtë 92.2, pikë ndërsa ankuesi nuk ka arritur të kalojë testin me shkrim dhe është vlerësuar me gjithsejtë 44.6, pikë.

Ankuesi Pajtim Kleçka e pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 10.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se kriteret e konkursit për pozitën ”Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, ka parashtruar ankesë në KPMSHCK me pretendimet e lartshënuara.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00015903 për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ” Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike

dhe Informim Akademik”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 1, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

*Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Arsim i Lartë i paspecifikuar*

*Përvoja e punës; së paku dy (2)vite përvojë punë profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;*

Rrjedhimisht, referuar çështjes juridike administrative Kolegji i Këshillit konstaton së Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, kushtet e konkursit kanë qenë në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, sipas numrit rendor 604 , ku përcaktohet se; ‘ *Zyrtar i lartë për njohje dhe barasvlerë të kualifikimeve në arsimin e lartë SHC-0604 Profesional 1 Grupi i arsimit Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie*’, ndërsa e Ministra e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë në rastin e shpalljes së konkursit me numër të referencës RN000115903, të datës 29.11.2024 për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 1, kushtet e përgjithshme kanë qenë *Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të Lartë të Nivelit të parë . ((Bachelor) Arsim i Lartë i paspecifikuar*, andaj mbi bazën e kësaj Kolegji i Këshillit konstaton së konkursi i shpallur nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton së Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, konkursin e datës 29.11.2024, me numër të referencës RN00015903, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ” Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, e ka publikuar edhe në kundërshtim me numrin rendor 48, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku thuhet se; *Grupi i arsimit, Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie.*

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se vendosja e kritereve të konkursit si dhe shpallja e rezultateve përfundimtare është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, dhe kjo ka bërë që procedura e rekrutimit të zhvillohet në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se: “1. **Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese**”, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në faktet e lartë përmendura më lartë, konstatohet se Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, me rastin e shpalljes së Njoftimit me numër protokolli 12/2025, të datës 11.02.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën “Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe

ka zbatuar gabimisht ligjin material duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i këshillit, konstaton së organi i punësimit Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas pranimit të këtij vendimi është e obliguar që të anulojë konkursin me numër të referencës RN00015903 për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ” Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Kualifikimeve Akademike dhe Informim Akademik”, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhimin nga kjo procedurë.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** **Lënda me numër A.nr. 435/2025**

**Rushit Kajtazi**

**Eshref Shabani**

**Procesmbajtës**

**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit P.K;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Arkivit të KPMSHCK-së;